



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.155, datë 16.06.2023

PËR

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZONJËS MALVINA PËLLUMBI,
KANDIDATE PËR MAGJISTRAT PROKURORE, E CILA DO TË DIPLOMOHET
NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2023”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokurorë zonjës Malvina Pëllumbi, e cila do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2023”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatës për t’u emëruar Prokurorë, zonjës Malvina Pëllumbi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Malvina Pëllumbi.
3. Lejimin e kandidatës Malvina Pëllumbi të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokurorë.
4. Të njoftohet për këtë vendim zonja Malvina Pëllumbi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla



ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj



ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Bujar Sheshi



ANËTAR
Nuriman Seifi



ANËTAR
Eloida Goxhi



ANËTAR
Esmeralda Keshi



ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza

